



Financuar nga
Bashkimi Evropian



National Convention for European Integration Working Group for Chapter 24

The Importance of Public Awareness on Money Laundering – Strengthening Cooperation with Non-State Actors

21 May 2025

RECOMMENDATIONS

Mbi Strategjinë për Edukimin e Publikut për Rrezikun e Pastrimit të Parave

- Është e rëndësishme të kuptohet se fenomeni i pastrimit të parave do të jetë gjithmonë i pranishëm. Prandaj, fokusi duhet të vendoset në **marrjen e masave me efekt parandalues**. Në këtë kuadër, edukimi i publikut duhet të trajtohet si një instrument parandalues për të shmangur risqet dhe për të kuptuar më mirë këtë fenomen.
- Për zbatimin efektiv të strategjisë, **nevojitet bashkërendim më i mire i punës** dhe angazhimit midis aktorëve të përfshirë. Ky bashkërendim duhet të shtrihet në dy drejtime: 1) **koordinim institucional** më i qartë mes institucioneve publike dhe agjencive ligjzbatuese (duke sqaruar fushat e përgjegjesisë), si dhe 2) **fuqizim i bashkëpunimit** me aktorët jo-shtetërorë si komuniteti i biznesit, shoqëria civile, akademikët dhe media.
- Lidhur me grupet e synuara për edukim dhe ndërgjegjësim, vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet:
 - **Komunitetit të biznesit**, I cili gjithnjë e më shpesh shënjestrohet apo keqpërdoret për pastrim parash. Nevojiten më shumë aktivitete informuese

**Ky sesion konsultues zhvillohet në kuadër të projektit “Nëdhëtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE”, me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian – IPA Civil Society Facility 2021, i cili zbatohet nga Lëvizja Europiane në Shqipëri dhe në bashkëpunim me Akademinë e Integritimit Evropian dhe Negociatave (AIEN), Slovak Foreign Policy Association (SFPA) dhe Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë (CTFI).*



Financuar nga
Bashkimi Evropian



dhe trajnime mbi veprat penale përkatëse dhe mënyrat e mbrojtjes nga keqpërdorimi I aktivitetit ekonomik.

- **Studentëve dhe të rinjve**, përmes bashkëpunimit me shkolla dhe universitete, për të rritur ndërgjegjësimin dhe njohuritë mbi këtë fenomen.
 - **Profesioneve të drejtësisë dhe institucioneve ligjzbatuese**, ku trajnimet mund të jenë edhe të detyrueshme, të shoqëruara me testim dhe certifikim. Praktika ka treguar se prokurorët, gjyqtarët dhe policia kanë nevojë për përditësim të vazhdueshëm mbi zhvillimet në këtë fushë.
- Modeli sllovak mbi edukimin përfshin tri faza të cilat mund të merren si modele të praktikave të mira për një edukim gjithëpërfshirës:
 1. Krijimi dhe shpërndarja e informacionit për grupet e synuara;
 2. Zhvillimi i materialeve dhe kurrikulave të përditësuara informuese dedikuar këtyre grupeve dhe interesave të tyre;
 3. Përfshirja e sa më shumë grupeve të interesit në aktivitete publike informuese dhe ndërgjegjësuere nëpërmjet mjeteve të informimit publik.

Mbi Rolin dhe Përfshirjen e Aktorëve Jo-Shtetërorë (komuniteti I biznesit, shoqëria civile, media, universitetet etj.)

- **Grupet e interesit që njihen si “gatekeepers”** (si gazetarë, përfaqësues të shoqërisë civile, biznesit, etj.) luajnë një rol të rëndësishëm në transparencë dhe sinjalizim të rasteve të dyshuara. Për këtë duhet që:
 - Institucionet publike të jenë **të hapura dhe transparente**, veçanërisht në të dhëna për bizneset, prokurimet publike dhe pronarët përfitues.
 - Gazetarët, OJF-të dhe komuniteti i biznesit të jenë të **vetë-motivuar për të sinjalizuar dhe monitoruar**, nëpërmjet analizës së të dhënave publike.
 - **Profesionistët e ligjit** si avokatët, noterët, kontabilistët apo bankat duhet të inkurajohen të bashkëpunojnë me autoritetet dhe të raportojnë mospërputhje apo raste të dyshimta. Ata mund të shërbejnë si ndërmjetës të besueshëm në verifikimin e të dhënave të pronësisë apo identifikimin e klientit.
 - Duhet të **njihet interesi legjitim** i gazetarëve dhe OJF-ve për akses në regjistrin e pronarëve përfitues, pa u penguar në praktikë.



Financuar nga
Bashkimi Evropian



- Të dhënat mbi përfituesit përfundimtarë të **fondeve publike, kontratave publike apo pasurive shtetërore** duhet të jenë të aksesueshme dhe transparente për publikun.
- **Shoqëria civile** duhet të angazhohet jo vetëm si aktor që kontribuon në luftën kundër pastrimit të parave, por edhe të ndërgjegjësohet për rrezikun që paraqet vetë përmes përdorimit të saj si mjet për pastrim parash. Ajo ka një rol të dyfishtë – si mbrojtëse dhe si e ekspozuar.
- **Aktorët jo-shtetërorë** si bizneset, media, bankat apo profesionistët e lirë duhet të vlerësohen për **ekspertizën, kapacitetet dhe burimet** që mund të ofrojnë. Për të bashkuar forcat me institucionet publike, së pari duhet të punohet në informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për përfitimet që sjell përfshirja në këtë proces.
- **Media dhe gazetarët** kanë një rol të pazëvendësueshëm në edukim dhe ndërgjegjësim. Kjo përfshirje duhet të realizohet në dy forma:
 - Përmes **trajnimeve të dedikuara për rritje kapacitetesh**, duke i njohur me fenomenin, terminologjinë dhe zhvillimet më të fundit.
 - Duke nxitur **gazetarinë investigative**, me më shumë hapësirë për artikuj analitikë dhe investigativë që shkojnë përtej raportimit të ngjarjeve.
- Institucionet publike duhet të jenë më **bashkëpunuese me median**, duke e informuar dhe përfshirë në aktivitetet publike për të garantuar mbulim mediatik dhe rritje të qasjes nga publiku.
- **Media duhet të jetë më proaktive**. Për shembull, në Sllovaki është vërejtur se rastet e suksesshme në luftën kundër pastrimit të parave janë promovuar në media – si rezultat i punës së institucioneve publike, por edhe për shkak të investimeve të shoqërisë civile apo biznesit. Këto raste shërbejnë si **nxitje për ndërgjegjësim dhe përfshirje të mëtejshme**.

On the Strategy for Public Education on the Risk of Money Laundering

**Ky sesion konsultues zhvillohet në kuadër të projektit “Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE”, me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian – IPA Civil Society Facility 2021, i cili zbatohet nga Lëvizja Europiane në Shqipëri dhe në bashkëpunim me Akademinë e Integritimit Europian dhe Negociatave (AIEN), Slovak Foreign Policy Association (SFPA) dhe Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë (CTFI).*



Financuar nga
Bashkimi Evropian



- It is important to acknowledge that the phenomenon of money laundering will always be present. Therefore, the focus should be on taking preventive measures. In this context, public education should be treated as a preventive tool to help mitigate risks and foster a deeper understanding of this issue.
- For the strategy to be effectively implemented, better coordination and engagement among the involved actors is necessary. This coordination should take place on two levels: 1. Improved institutional coordination among public bodies and law enforcement agencies, with a clear definition of their respective responsibilities; 2. Strengthened cooperation with non-state actors such as the business community, civil society, academia, and the media.
- Regarding the target groups for education and awareness-raising efforts, special attention should be paid to:
 - The business community, which is increasingly being targeted or misused for money laundering purposes. More informative activities and trainings are needed to raise awareness of the relevant criminal offenses and ways to protect economic activity from being misused.
 - Students and young people, through cooperation with schools and universities, in order to raise awareness and build knowledge about this phenomenon from an early stage.
 - Legal professionals and law enforcement institutions where trainings may even be mandatory and accompanied by testing and certification. Practice has shown that prosecutors, judges, and the police require continuous updates on developments in this field.
- The Slovak model for education includes three phases, which may serve as examples of good practice for inclusive public education: 1. Creating and disseminating information for targeted groups; 2. Developing up-to-date educational materials and curricula tailored to the needs and interests of these groups; 3. Involving as many stakeholders as possible in public outreach and awareness-raising activities through public information channels.



Financuar nga
Bashkimi Evropian



On the Role and Involvement of Non-State Actors (business community, civil society, media, universities, etc.)

- The stakeholders known as "gatekeepers" (such as journalists, representatives of civil society, business, etc.) play an important role in ensuring transparency and flagging suspicious cases. To support this, the following are necessary:
 - o Public institutions must be open and transparent, especially regarding data on businesses, public procurement, and beneficial owners.
 - o Journalists, NGOs, and the business community must be self-motivated to signal and monitor cases, through analysis of public data.
 - o Legal professionals such as lawyers, notaries, accountants, or banks should be encouraged to cooperate with authorities and report discrepancies or suspicious cases. They can serve as trusted intermediaries in verifying ownership data or identifying clients.
 - o The legitimate interest of journalists and NGOs to access the register of beneficial owners must be recognized, without practical obstacles.
 - o Data on the ultimate beneficiaries of public funds, public contracts, or state assets should be accessible and transparent to the public.

- Civil society must be engaged not only as an actor that contributes to the fight against money laundering but also made aware of the risk it poses through its potential misuse as a tool for money laundering. It has a dual role – as a protector and as an entity at risk.

- Non-state actors such as businesses, media, banks, or independent professionals should be valued for the expertise, capacities, and resources they can offer. To join forces with public institutions, the first step must be to inform and raise their awareness of the benefits of being part of this process.

- The media and journalists have an irreplaceable role in education and awareness-raising. This involvement should take place in two forms:
 - o Through dedicated capacity-building trainings, familiarizing them with the phenomenon, terminology, and the latest developments.
 - o By encouraging investigative journalism, with more space for analytical and investigative articles that go beyond event reporting.



Financuar nga
Bashkimi Evropian



- Public institutions must be more cooperative with the media, by informing and involving them in public activities to ensure media coverage and increase public outreach.
- The media should be more proactive. For example, in Slovakia it has been observed that successful cases in the fight against money laundering have been promoted in the media – as a result of the work of public institutions, but also due to investigations by civil society or the business sector. These cases serve as an incentive for greater awareness and further involvement.